Delvina Kërluku



GJURMË

TringaDesign
where the quality has meaning

Delvina Kërluku

G J U R M Ë

(poezi)

TringaDesign
where the quality has meaning

Delvina Kërluku: Gjurmë (poezi)

Redaktor: Adem Gashi
Kopertina: Rilind Kërluku

© Delvina Kërluku

Sponsorizoj: Shoqata JOSIF BAGERI

Shtëpia botuese: TRINGA DESIGN, Tetovë, 2011

Ajnik

Unë jam

..., qeshje në gëzim
qarje në pikëllim
vullnet në sosje
mëshirë në kanosje
përballje,

.., vlerësim në vlerë
jetë në dashuri
zbatim në premtim
nxjerrje në trishtim
këndim në himn
fitore në luftë
busull e shpresës,

në misionin e dritës.

Flamuri

Valëvitu kuq e zi
Në qiellin kaltërosh
Në troje shqipesh, Shqipëri

Valëvitu flamur
Në çdo shtëpi
Ku jehon fjala shqip, Shqipëri

Valëvitu, valo, flamur
Krenar në krenari

Valëvitu flamur
në krahët e mi
Ç'ndjenjë e zjarrtë të jesh shqiptar
Të kesh nënën Shqipëri

Flamuri ynë
Në ajër në zemër në gji
kuq e zi…

Thirrje atërore

Delvinë, qyteti i kalasë
Që bëre luftë dhe me shpatë,
Kohëve që u këndoi dhe Hani vetë
Ilirëve të lirë, shqiptarëve me fletë.

Delvinë, ëndërr flurore në rini
Më jep zemër, burrëri,
Armë prej luftëtari
Kënduar Shekujve nga lahutari.

Nostalgjia më ziente në gji
Ndaj i vura emrin tënd sime bijë -
Ta gëzojë me nder e urtësi,
Buzëqeshje engjëlli kaltërsi.

Shpesh më zgjon nga gjumi
Në një lëndinë lulesh bozhuri
E hapin e bën marshim,
E lajmin e ditës ma bën gëzim.

Sa petale ka kjo burbuqe?
Ajo bëhet gonxhe lulëkuqe
Pikë vese në petale
Syve të saj pikojnë kristale.

Delvina më rri përball
E zemrën ma bën mal,
E më thotë: shih, o babi,
Një Rilind ka sot Shqiptari.

Saranda të solli veç hare,
Ulza, të dha fuqi pa fund
Për mua, ti e the vetë
T'u bëra krah, të dhashë fletë.

Delvina, më në fund
Ëndrrat e bardha i përkund,
Si shpresat, si dëshirat
Për babanë gjithë Të mirat.

Adem Jashari

Kosova më thirri në tryezë,
në gosti,
E ngre dollinë e hedh valle

Dhe kur zbraz kupën plot me
verë
Unë – Rinia, daullja dhe trumbeta
po bërtasim për trimërinë e tij...
Adem Jashari

Nënëlokja ime

Për ty, Nënëloke
Digjem e tretem mallit,
E luftë bëj e hidhem zjarrit.

S'më ndal armik as helm i gjarprit,
Asgjë s'më ndal,
Po ta dojë nevoja
Hidhem në varr e gjallë

Një grusht dhe e një copë tokë
E bëj shtrat e bëj mbulojë

Truall, gurë, baltë e rrufe
Bëhem në çast -
Për ty, atdhe.

Hero

S'të lëvdoj unë,
Të lavdëron vepra
Hero,
Dhe adhurimi vjen vetiu
Shtegut të amshueshëm -
I adhurueshëm.

Pangopje

Të dëgjoj, të ndiej,
sa afër të kam.
Të puth, të përkëdhel,
Sërish të puth -
afër të jam.
Të shoh, të prek
Sërish të shoh.

E ku ngopet njeriu?

Dilemë

Në mënyrë të çuditshme ti më buzëqesh
E unë s`e di: të vrenjtëm a të qesh?
Sytë e tu shpesh më kërkojnë
E sytë e mi këtë shkas kërkojnë.

E ç'faj kam unë kur çiltërsia
Ma le hapur veç një derë:
Dilemë, dilemë, dilemë.

Megjithatë ka një shteg
Që s'njeh pengesë që nuk sheh vëngër:
Është veç një ëndërr, veç një ëndërr
Ku Njeriu takon Njeriun,
Është një rrugë
Që nuk matet me kilometër,
Një rrugë tjetër, një rrugë tjetër
Ku Njeriu takon Njeriun.

Është dhe një tremë...
E lëmë Dilemë!

Larg

Në stacionin e trenit tutje diku
E lodhur e tretur, fare e vetme, pres...
Rrugës plot drita e njerëz të huaj
Një përshëndetje nuk më vjen.

Më vjen ndër mend si qe më parë
Kur të qeshurat tona bënin hatanë,
E rendnim tok e tok
E kohën s'e ndjenim dot
Si ikte moskthimit.

Tash pres trenin të vijë
Po treni i pritjes më mbush vetmi,
E vetmia m'i mbush sytë lot
Dhe si në një vegulli
Të dashurit e zemrës pranë i ndiej,
E bëj fjalë me kujtimet e qesh me zë.

Lot e qeshje në një log:
Një bori gjumit më zgjon.

Mbështetur kokën në xham
Tek kthehem kujtimesh:
Në krah të kam.

Rrugë e ëndrrës

Rrugë të humbura në përmallime
Ardhje, vajtje, labirinte
Me një bagazh të rëndë kujtime.

Vetmuar mes njerëzve të huaj
Ecje, rrugë, fjalëkryqe.

Rrugë ëndrre që më shpien
Në mbretëri engjëjsh qiellit të ri
Po dorë të zgjatur
S'prek dot njeri.

S'është...
Veçse rrugë ëndrre.

Mos u kthe

Mos e kthe erën e dashurisë!
Në të fllad i lehtë erëmon
E zemrat peshë i çon.

Dashuria rifillon.

Në truallin tim

Dritë e një dielli tjetër sytë m'i vrau
Si të mos e kisha parë qiellin qëkur

Ndihesha si në një skëterrë
Udhëhumbur, helm e vrer
Rrugën e parajsës duke kërkuar.

Më thuaj një fjalë, të lutem, o udhëtar
Ti që kilometrat me lot në sy i numëron

Mos më lër të ndihem e huaj në tren

Sytë drejtuar qiellit i bëj Lutje:
Në agim,
Dua të jem në truallin tim.

Bisedë me erën

Fryj, erë e ashpër dhe e ftohtë
Fryj, erë e rreptë ngjethëse
Ngrije pluhurin e këpucëve të mia,
Ta dijë ky popull -
Ç'domethënë rëndesa,
Rëndësia e veprave të mira!

Jo fantazmë po vepër
Le të shfaqet në çdo derë:
Kjo penë ka vlerë!

Erë e ashpër fryj!
Unë jam këtu, unë jam aty
Jam vetë dëshmi.

Gjallësia

Në terr të natës rri
errësira humnerë,
pafundësi.

Pa ndjenja jete
veç shpresa...

Kur gjë s'pipëtin
Veç shpezëve të natës
Gjallësia rilind
Në një frymëmarrje.

Eja, zë

Eja zë dashurie,
Trishtimin
në netët e errëta ma thyen.

Eja zë malli (imi),
Ma shuaj etjen për dashurinë!

Zë, më pështpërit, eja
Jeta ime të marrë flatra
Qiellit të lirë,
Zë toke qielli, hapësirë.

Mësomë

Mësomë, kitarës t'i bie!

Në një tingull, në një melodi
Ta nxjerr një shkëndijë
Për zjarr dashurie.

Më mëso të vdes bukur!

Kënga e dashurisë sonë
Do të jetojë si jehonë.

Rastësi

Asgjë nuk rritet vetiu,
Unë, vullnetare e shoqërisë
Lulet, tokën ujis.

Dielli më dashuron
Në trajtë rrezesh.

Nata më zhvesh më zbulon,
Unë e Hëna
Japim e marrin nga njëra-tjetra.

Vë veshin e dëgjoj
Këngëtarin e vetmuar sonte:

Kush humb zemrën, kush çel thesarin.

Lutje poetit

I nderuar njeri-poet
shamë derisa jam gjallë,

Kur të vdes
Qiellit pa anë e skaj
Do të bredh shpirti pa varr.

...pastaj gjithçka
Do të mbetet vetëm këngë e vaj.

Ekzistoj

Ti, sy në mua,
Shqipe

Ti grusht në mua,
Unë trazoj –
Domethënë ndjej
Ekzistoj.

Buzëqeshja

Buzëqeshja më vjen
pas zërit tënd
krejt si një zog që cicërin

...e më zgjon.

Në sytë e mi
çelen petale lulesh

Në magjistralen e dashurisë
Merr ritëm të ri
Jeta.

Dashuria më tremb

Sa kam frikë aq edhe të dua
kjo më tremb, më ngre lakun
(xhelozia më prish gjakun)

Janë shoqe frika dhe dashuria
më rrinë rriqër pa kufi të dyja
(zemrën ma di)

Sa kam frikë aq edhe të dua
dashuria më tremb qoftë edhe lehtë
(Po, ka frikë në dashuri të nxehtë?).

Lumturia ka peshë

Merrma frymën
E jeta le të ikë!

Të dyja një ditë
Do të ndeshen në pritë
Në humnerën e dashurisë.

Nuk e paskam ditur
Se lumturia ka çmim!

Ç'mbjell atë korr

Vërtitet rreth e rrotull, çirret
Me tingullin e fundit thërret
Shpresa zë mbytet në det.

Gjendje që përgjigje s`ka,
Në ç'humnerë ke rënë, në ç'hata
Që njeri zërin s'ta dëgjon,
Mos në ferr në një hon
Digjesh e përcëllon?

Klithma jote bëhet jehonë:
- Këtu shpirti më trazon,
Eja engjëll,
Buzët e tua thërrasin
Po bie më në fund tiktaku
E shpirti si i qenit po të del
Ç`ke bërë vallë që këtë po korr
Kaq plagë në kraharor?

Baladë kurbeti

Të kërrusur
e të shtrënguar

Të shqetësuar
si deti i trazuar

Vanë e lanë Arbërinë
për bukën e gojës,
Morën arratinë...

Heshtja

Heshtja s'ka zhurmë
(domethënë si vdekja)

Ajo më vret, më merr
(më bën si vetja)
s'di pse,
Kur ti hesht!

Mërgimi

Dy pika lot,
riguan mbi vatër,
njerëzit larg
lotojnë natën...

Yjet rrëfejnë
për kohën që rrjedh,
dita gdhin me shpresë
nata me dhembje vjen.

Njerëzit, ku mbetën...

Shtëpia e vetmuar
ruan një shpresë,
lot në vatër,
zjarr pa flakë,
mall për një agim.

Për një agim të ri.

…Ma mbush shpirtin
veç tingulli i emrit tënd

Kur fryn si erë maji përkëdhel rreze dielli,
Kur papritmas të shoh më shfaqesh nga qielli,
Lule menekshe lehtas më thotë fjalë me mënd.

Kur s'je aty drobitem vetmie, frikësohem,
Por e di se edhe ty të dhëmb,
Gjithmonë pyes veten në delir mrekullie
Si mund të plazmojë e gjallë dashuria,
Në mija kilometra larg.

Një zjarr që rri ndezur
Në lotët e mallit në sy.

Hija

Hija ime dhe jotja
Ujiten me lot malli
Ndarë nga guri i vatrës,

Hija ime dhe jotja
Rriten me mallin
për njëra-tjetrën,

Hija ime dhe jotja
Nga mërzia
derdhin inatin, vrerin e ndarjes
Në trajtë lotësh.

Hija ime dhe hija jotja
Tani vetëm ëndërrojnë.

Si njeriu, njeriut

Të shkoj a të pres?

Pyes i trallisur
Shpirt boshatisur
Zemër llahtarisur.

Të shkoj...
Rruga ç'më fanitet
Zemra më digjet
"Mora rrugën për Janinë, ooo!"
Pa arabaxhinë, ooo!

Në mes flakë zjarri
Në fund deti pa fund.

Më thuaj,
si i thonë njeriu - njeriut!

Martesa

Bëhem luginë
Ku ti ngashënjehesh

Bëhem rrugë
Ku ti të ecësh

Bëhem mal
Ku ti të ngjitesh

Bëhem burim
Ku ti shuan etjen

Bëhem grua,
Tokë bëhem
Të rris bimën, lulen.

D

Afërsia me ty
më shndërron në lot

Largësia më përmend,

Dashuri s'është
Veçse një kënd heshtjeje
Që më ngjall e më vdes,
E më çmend fare.

Njeri

Kur ke dashuri
ti je dikush,
kudo dhe ngado
në zemër, në mëndje
shpirt.

Në tradhti
je askush dhe askund
kudo dhe ngado të jesh
ti nuk je
veçse një hiç.

Larg sysh, larg zemrës

Fuqia jonë e vakët
hapat na i ndal
dhe pikëtakimet mbesin bosh.

Të harruar në rrugë qëndrojmë
Statuja anonime
Dhe shirat derdhen
mbi trupat tanë

E shpirtrat
Na bëhen plagë.

Me dhimbje rrojmë

Edhe Dashuria
dhemb
çmend

Prandaj, Të dua...

Vallë,
Edhe dhimbja qenka
jetë?

Të dua,
prandaj..

E bekuara

Si margaritar loti yt
mbi vello të bardhë pikoi
Po nurin nusëror s`ta prishi dot,
Dhe yjet e natës së gushtit
Me bukurinë tënde i zgjoi.

Edhe mali Korabi
Dajret, lodrat e buritë i dëgjoi,
Dasmorët me hare si yje
Nuk përmbaheshin dot.

Një shpirt i kthjellët vajzërie
Nga gëzimi e dhimbja
dukej se nuk qante, por bëhej lot.

Ti nuse bëhesh sot
Bashkë me kujtimet pjesë paje
Dhe natën e lotëve si një dekor,
Me aureolë bekimi
Nga i madhi Zot.

S'pipëtin

Pritje me ankth
Pritje e vjetër
Pritje e mykur në kohë me shi
Pritje e vonuar...

Ditët rendin, të vranëta me shi
Filtri i cigares digjet në gishtërinj
S`pipëtin asgjë, s`e pret të vijë

Dashuria humb dritën
Në mbretërinë errëti.

Ç'fshihet?

Më thuaj ç'fshihet nën mallin tim,
një lot me pikëllim
dhimbje e një zemre
a puthja e parë e një femre?

Ç'fshihet vallë në buzët e mia,
Fjalët e para nga fëmijëria
Puthjet e para nga dashuria
Fjalët e pathëna
A vetë egërsia?

Nata më fsheh

Sonte nata s'më përkund
as sytë s'm'i mbyll
Sytë hapur më janë
trup e shpirt lidhur i kam

Rri, çmendem në terrinë
nata trishtuese ka melodinë
në mendimet e mia

Unë qaj, shaj, dua
Nata errësirë fytyrën ma fsheh

Po nuk fsheh lotin që rrjedh.

Ti ekziston

S'të shoh
S'të prek
dhe unë dashuri
ndjej!
Shprese jete
më jep
Dhimbjen e ndaj
dhe ma tret
Gëzimin ta jap
dhe ma zgjat...

Ngadhënjim beteje

Sonte mund të pi një gotë,
një gotë me pasurinë e kësaj nate
të devotshme,
fitimprurëse.

Një gotë në buzët e mia
plot etje,
një gotë shuarje,
një gotë ngadhënjimi
në betejë.

Një gotë marr e puth e pi me buzë
me një pikëpirje dehem
Rrëzohem,
bie në duart e pishtarit
Ç'prehje!

Madrigal

Dashuri e vërtetë

Larg me vite
Me thinja u pamë
Sy më sy
Dhe u puthëm
Për çudi
Ekzistuaka e shenjta dashuri!

Rroj larg
Dhe kam..!
Një ndjenjë, një dashuri.

Përsëri them:
Të dua si gjithnjë.

Pasion i vërtet

Kur ti je larg
Unë zërin tënd si jehonë
E dëgjoj
Dhe hapat në pragun e derës i ndiej
Çdo rrahje të zemrës tënde kërkoj
Frymëmarrjen tënde dua ta thith
Ngrohtësia e trupit, trupin tënd fton
E në netët pa gjumë imagjinoj
Trajtat e tua,
Paj, ti je vetë.

Dhe s'qenka tjetër ky
Veçse pasioni i vërtetë.

Platitem

Të ndjej ty dhe përqafimet e tua
kilometra të tëra larg
Dhe më vijnë që andej
Prekjet e tua e puthjet në gjuhën e zjarrtë

Lërmë në brendësinë time,
Flakën tënde ta ndiej
T`a di se si është kur trupi
Në mornica mbërthehet
Minuta dhe çasti po afron
Dallgët e mia të tuave u përgjigjen,
Kush s'do të donte të fundosej andej

Nga thellësia e shpirtit
Klithma e pasionit shpërthen
Dhe veten në lehtësinë e kënaqësisë
Të shkrihet e le.

Oh, dëshirë e flaktë të të kem pranë
të të ndiej, të të ndjej

A s'është vetë kjo
Pavdekësia!

Të jam besnike

Mik, të dhashë dashurinë
Të lidha në shpirt, rrotull të ndrydha
me rrathë çeliku
dhe nuk u lodha,
as desha të përkëdhel shokë të ri,

Besa me besë, - të thashë
përjetë tek ty!

Natë e çmuar

Sonte pa sy e gjej udhën
Dal pa shikuar, s'di ku vete
Me syrin të mbërthyer, trokas
Pengohem te zemra jote
Ajo perlë, margaritar
llavë derdh në mua

Natë dhe Dashuri
e çmuar!

Një vashës

Syri yt pa – larg
dhe s'rreshti pa e afruar,
Syri yt e ka – afër,
dhe ndenji duke e vështruar

Me duar vazhdoi duke e lëmuar
dhe e quajti atë – bukuri
që e do me shpirt
si perëndi.

Përballë

Në sytë e tu fytyra ime,
Në sytë e mi fytyra jote:
Zemra zemrës i troket,
Bashkohen

Ç'zemra lozonjare
Lodhen e çlodhen.

Të treturit
(pa gjurmë, pa varr)

Dhe s'kthehet prapë, vallë!?
Ja morën kurorën, jetën e gjithçka që pat
N'mënyrë barbare vdekja e tij
varrimi-tinës
Dhe unë ende se gjej,
ku është dhe (ku je) s'e di?!

As shpatë pati
as helmetë, as dekoratë
as krisma nderimi
që bie trimi
as lutje e rrite...

Shpirti i tij
që nga qielli e deri në dhe
nis klithmat rrufe:
-Dua dritë!
Dhe unë s'e gjej dot
e gjallë përmbi dhe.

Shqiptar i Maqedonisë

Ishim si nuse e pritme
e Kosovës dhe Shqipërisë
Ku ne prisnim kulmin e lumturisë
të lavdisë...

Fati ynë mori tatëpjetë
në mjerim
në marrëzi
e në varr.

Ne ishim si nuse e pritme
e Kosovës dhe Shqipërisë
Por koha shkëmbinj në mes na vuri
Kriminelët shkelin drejtësinë
blejnë ligjin, vjedhin tokën
vatrën e Nënëlokes.

E gjaku m'u nxeh e m'u bë vrer
edhe miqtë m'u bënë armiq

Qenia ime këtu u zhbë,
shpirti e gjuha flakë m'u ndez
Ku je mik,
Në truallin tënd vjen një armik
Ti le nusen e vetë ik?

Unë jam në pritje deri në amshim:
Vetëm Bashkim.

Pikëllim për ndarje

Çdo ditë vdes nga pak,
sepse Zoti
ma bën më të ëmbël vdekjen!

Çdo ditë vdes nga pak,
sepse ofshamat e Nënës Loke
për bijtë e saj shqiptarë
(ç'pikëllim, u ndanë!)
Lëngatë në zemrën time,
më ndjek pas klithma e saj,
dhe unë po vdes nga pak
sepse Zoti
ma bën më të ëmbël vdekjen!

Në luftë me veten

Veten
e grij
e ha
e sos...
Përsëri gjallë,
Rritem e rritem.

Në luftë me veten:
Veten
e griej
e ha
e sos...
Derisa të çarat
si rrjedhat e gjakderdhjes
më shtrijnë përdhe,
sfilitem, mekem.

Shko

Shko më tutje
aty ku dielli perëndon
që kthimi yt të jetë i vështirë

Mos ndoshta atëherë
më mungon
dhe them -
kam humbur dashurinë.

Predikim

Mësues i mërrolur
Më tha: ec udhës së ngushtë,
pa devijim.

Vetë ai (si hipokrit)
pa mëndje, pa fre
baret për verë,
lulevere dhe dëfrimi.

Dhe vesh nuk ka
as gishtin vë në kokë.

Nuse

Zogëzës dorën ia doje
Vel i vije përmbi kokë
Nuse shtatselvi,
Të bukurën natë e shijoje
Në gjirin e bardhë
dhe kokën pushoje e psherëtima
(qiellore, idhull i shpirtit tim!)
lëshoje.

Këtu ka jetë

Unë punoj
në vendlindje
t'u mësoj
se ka të ardhme,

Unë bëj
për të treguar
që nuk ka
më të shkuar...

Bota jonë

Njëri qan e tjetri qesh
Njëri fle, tjetrin e ha vreri,
Të gjithë vdesim e na merr varri.

Kështu qenka bota, njerëzia
Njëri në parajsë
Tjetrin e pret ferri!

Ç'bën atdheu për mua?!

... atdheu ...
S'më dha bukë të rritem
S'më dha tokë të mbjell
S'më dha varr të vdes

Më dha ujë - lot
Më dha ajër - jetë
që ta dua, përjetë...

I varrosuri i gjallë

Humbur diku në mes gërmadhave
Brenda skëterrës
I lutet Zotit që (njeri) ta gjejë
Dhe s`di në është i gjallë apo i vdekur.

Në dorë ka dorën e djalit
Që pa thënë gjë, shpirtin e dha
Koha kalon, natë a ditë se ç`është s`e di
E veten e pyet me psherëtimë,
Shpresat kanë thënë që s`po e kërkojnë
(thua do të shohë tjetër agim?)

Një çast ngrihet një copë dheu mbi të
E drita e pritur sytë ia vret
Pyet Zotin pse s`e la atje.

Ngrihen gërmadhat e çohet pesha
E vërteta e grin dhe e plak
Njerëzit e shikojnë e belbëzojnë:
``Ky qenka i varrosuri i gjallë!``

Thirrja e Kosovës

U sosa duke pritur
Dua të më rrjedhë gjaku im
Për t'u ndjerë e lirë

Pastaj lotët
Le ta mbushin trupin të tërë
plot Pavarësi do të jem...

Deti Jon

Det
Të flas
Ti hesht e luan me valë

Syri im të sheh ty
Mrekulli

...Dhe dua të zhytem aty tek ti
(vras mendjen të vij tek ti
apo të rroj me timen dashuri!?)

Të rrëshqas
Fundja
Të bëj dashuri.

Pritje

E hënë, e martë, e mërkurë...
Ikën kështu ditët sërish
E unë në mes të njerëzve diku
Pres për një ditë më të mirë

Se gjethet filluan sërish të vyshken
Pa thënë dhe ata të fundit lamtumirë,
U ndave dhe ti papritur nga jeta ime
E dhimbje shkaktove në shpirtin tim.

Dhe ditët rendin:
E hënë, e martë, e mërkurë...
Dhe shpirti im akoma
Pret, kërkon e bëhet urë.

Heroinë

S'kam mjeshtri që t'i vargojë
psherëtimat e mia
Por unë dua,
oh sa fort dua, pa masë
(të thuren vargje për mua)

E hap zemrën, gojën, veshët
Turrem andej, këndej
Në agjërim e hidhërim
në pagjumë e dobësi
në marrëzi sillem vërdallë
si të gjithë,
për dashurinë
atdheun
u bëmë të marrë.

Mendimi

Mendimi bredh
lirshëm
Si retë në qiell

Herë shfaqet në tokë
Herë tretet në hapësirë.

Eja Shqiponja nënë

Fluturo, fluturo e dashur
ç'gëzim, ç'hare, ç'frikë!

Fluturo e dashur në qiellin kaltërosh
plot liri,
dhe unë vuaj, të pres ty
të dua si gjithnjë.

Fluturo, fluturo e dashur
përtej lumturisë,
Fluturo deri tek pragu i fëmijës
plot nostalgji!

Eja!
Fluturo!
Gëzimi të rilindë.

Dhimbja DASHURI s'do të ketë fund

Mendimet më vërtiten
Turbull nëpër kokë
Gjallë apo vdekur, s'di se ç'jam
Njëherë kam sytë e mbytur në lot
Njëherë si Saharë të tharë i kam.

Trupi po më digjet si në prush të Ferrit
më është tretur dhe po bëhet hi
Shkëndijat e yjeve prej në kupë të qiellit
Po më ngulen si shigjeta në gji
Ditët, javët, muajt më duken si vite
Netët e gjata të dimrit si shekuj, pa fund.

Nga dita që ike më dogje më fike
Kam mbetur vetëm, si statujë në shi.

Ndoshta do të ndodhë që ne të shihemi
Në ferr apo parajsë – Zoti e di
Dashura ime - Dhimbja-dashuri
s'do të ketë fund, këtë dije ti.

Zoti jep zgjidhje

Ti, qan
vuan
zgjidhje kërkon

Kur Zoti të rri pranë
ka aq zgjidhje
sa yje në qiell...

Je...

Je dritëbardhë si bora
Kur nata, ditën mbulon

Je hëna që nuk fshihesh
në hapat e mia,
që shndrit tokën e zezë.

Je veshja ime që më ngroh
në acaret me ngrica

Je fryma e ekzistencës time
që quhet Jetë.

Zemra për zemrën

Të kam sosë, e di!
Ti je shembulli i dashurisë
që unë s'e gjej kund.

Je shembulli i dijes,
që s'arrij të di sa ti.

Je pikëmbështetja ime
që më çlodh.

Je siguria ime ti
askush s'më vret dot.

Je fjala ime në dhomë rrëfimi
dhe e shpërthimit
në hidhërim.

Bota vetë je
Jeta.

Lodhje

Lodhje me fjalët e botës
Me rregulla e fjalime,
Lodhje në mëngjeset, mbrëmjet
E zhegun e ditëve,
Lodhje rrugëve plot llahtari pa fund
Lodhje në pritje dhe netëve pa gjumë
Lodhje nga malli i grirë dhe i tretur
Në vetmi e mbetur
Lodhje me ty dhe vetveten

A thua kur do të pushoj?

Në djall

Ti s'mund të mbetesh në mes
Të rrugës sate
Sado që fundit po i afrohesh

Unë me sy të ftoj, me gjeste të thërras
Po ty shikimet e tjetrës të kthejnë pas

Mes turmës provon të më gjesh,
Por unë aty më s'do të jem.

Do të më lutesh
që krahët t'i kthej një ditë,
Por do të jetë vonë.

Nga buzët e mia tjetër s'do të dëgjosh
Pos:
"Në djall të tëra!".

Të erdhi ora

Engjëll
ti vjen në formë të çuditshme
Qoftë për mbarë,
a ardhje e prapë,
ti sjell aromë parajse
a tufan ferri?

Qëllimi i tij, i mirë a i lig,
të rëmben!

Veç pavdekësia ruan një fron
Për bëmën tonë
E të shpirtit.

Ky shpirt do paqe
edhe në kohë lufte!

Iki me zhgënjim
nga miqtë,
të hapurat dyer i mbylla
për hipokritët, rrenacakët, smirëzinjtë
që silleshin si engjëj të dashuruar.

Ky shpirt do paqe

Ku vajte të pyes - një ditë
veç s'dua të kthehem në trishtim
sërisht ballë renave të jetës...

Terr

Sot
fjala ime
terr
të çau zemrën,

Nata vuri errësirën
tunel mes nesh

Kjo (ish) dashuri
vdes.

Gjithçka vdes

Më rri larg
dhe pas shumë mundimeve
u bëra imun.

Por,
ndjenja s'shuhet!

Dhe mendimi qëndron:
... rron a nuk rron!?

Dhe kjo tutje
Vjen e shkon...

Ç'njeri!

Ti le derën hapur,
le diellin të hyjë

Ndeshet vashëza
në zemrën,
në shpirtin tënd të zi

Ç'fat(keqësi) të lindi ty?!

PËRMBAJTJA

AJNIK 3
Unë jam 5
Flamuri 6
Thirrje atërore 7
Adem Jashari 9
Nënëlokja ime 10
Hero 11
Pangopje 12
Dilemë 13
Larg 14
Rrugë e ëndrrës 15
Mos u kthe 16
Në truallin tim 17
Bisedë me erën 18
Gjallësia 19
Eja, zë 20
Mësomë 21
Rastësi 22
Lutje poetit 23
Ekzistoj 24
Buzëqeshja 25
Dashuria më tremb 26
Lumturia ka peshë 27
Ç'mbjell atë korr 27
Baladë kurbeti 28
Heshtja 29
Mërgimi 30
Ma mbush shpirtin veç tingulli i emrit tënd 31
Hija 32
Si njeriu, njeriut 33
Martesa 34
D 35
Njeri 36
Larg sysh, larg zemrës 37
Me dhimbje rrojmë 39
E bekuara 40
S'pipëtin 41
Ç'fshihet? 42
Nata më fsheh 43
i ekziston 44
Ngadhënjim beteje 45

MADRIGAL 47
Dashuri e vërtetë 49
Pasion i vërtet 50
Platitem 51
Të jam besnike 52
Natë e çmuar 53
Një vashës 54
Përballë 55
Të treturit (pa gjurmë, pa varr) 56
Shqiptar i Maqedonisë 57
Pikëllim për ndarje 58
Në luftë me veten 59
Shko 60
Predikim 61
Nuse 62
Këtu ka jetë 63
Bota jonë 64
Ç'bën atdheu për mua?! 65
I varrosuri i gjallë 66
Thirrja e Kosovës 67
Deti Jon 68
Pritje 69
Heroinë 70
Mendimi 71
Eja Shqiponja nënë 72
Dhimbja DASHURI s`do të ketë fund 73
Zoti jep zgjidhje 74
Je... 75
Zemra për zemrën 76
Lodhje 77
Në djall 78
Të erdhi ora 79
Ky shpirt do paqe 80
Terr 81
Gjithçka vdes 82
Ç'njeri! 83

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека
"Св. Климент Охридски", Скопје

821.18(497.7)-1

KËRLUKU, Delvina
Gjurmë : (poezi) / Delvina Kërluku. - Tetovë :
Tringa design,
2011. - 83 стр. ; 21 см

ISBN 978-608-211-037-0

COBISS.MK-ID 87363594

Unë jam

...qeshje në gëzim
qarje në pikëllim
vullnet në sosje
mëshirë në kanosje
përballje,

...vlerësim në vlerë
jetë në dashuri
zbatim në premtim
nxjerrje në trishtim
këndim në himn
fitore në luftë
busull e shpresës,

në misionin e dritës...

Për librin e Delvinës:
Rreth tetëdhjetë vjet më parë, një poet fin e i ri, në Kangët e pakendueme, lëshonte një zë klithme, fatalisht të dhembshur: "Unë djepi juej e ndoshta edhe vorri juej". Në të vërtetë ai shqiptonte formulën e të gjitha kohëve se poezia është ultima verba e autorit, e ngjashme me gjithë sojin e saj, po aq sa edhe e mëvetësishme dhe e pangjarë me të tjerat. Brenda këtij ditari lirik e gjej edhe botën e vargjeve të Delvinës.
Ajo, në librin "Gjurmë", dëshmon se ka dije, kulturë dhe ndjeshmëri në po atë masë sa t'i japë vetës luksin të jetë vetvetja, pa çka se vargu i saj mund të marrë, kur e kur, edhe nuanca rebelimi e profaniteti. Ajo shquan, identifikon po edhe le gjurmë në perandorinë e poezisë.
Kënga dhe vaji i saj është magma e shpirtit që derdhet në trajtë vargjesh, herë prajshëm e herë vrullshëm.
Ajo di të lexojë heshtjen midis zhurmës, sikundër edhe vetminë midis turmës dhe te kundërtën e tyre. Edhe vetëm ky fakt është i mjaftueshëm që të bëhet pronë leximi ky libër.

Adem GASHI

ISBN: 978-608-211-037-0